



MISIONI NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGIN E ZGJEDHJEVE

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë – Zgjedhjet Lokale, 7 prill 2013

DEKLARATA PËR KONSTATIMET DHE PËRFUNDIMET PRELIMINARE

Shkup, 8 prill 2013 – Pas ftesës së marrë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe në bazë të rekomandimeve të Misionit për Vlerësimin e Nevojave që u realizua prej 28 deri më 31 janar, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (OSBE/ODIHR) e vendosi Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) për zgjedhjet lokale të vitit 2013. MVZ i OSBE/ODIHR-it mbeti në vend me kapacitet të zvogëluar për ta vëzhguar rrethin e dytë të zgjedhjeve më 7 prill. MVZ-ja e zvogluar e OSBE/ODIHR-it nuk realizoi vëzhgim gjithpërfshirës dhe sistematik të procedurave në ditën e zgjedhjeve, por vizitoi një numër të caktuar vendvotimesh në mbarë vendin.

Rrethi i dytë i zgjedhjeve lokale vlerësohet për përputhshmërinë me përkushtimet e OSBE-së dhe standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin e vendit. Kjo deklaratë duhet të trajtohet së bashku me Deklaratën për Konstatimet dhe Përfundimet Preliminare të publikuar më 25 mars pas rrethit të parë të zgjedhjeve nga MVZ i OSBE/ODIHR-it dhe Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës¹. Vlerësimi i përgjithshëm i zgjedhjeve të do varet pjesërisht nga realizimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, duke e përfshirë edhe mbledhjen dhe shpalljen e rezultateve dhe trajtimin e parashtrësive dhe ankesave të mundshme pas ditës së zgjedhjeve.

PËRFUNDIMET PRELIMINARE

Si edhe zgjedhjet e rrethit të parë, edhe zgjedhjet e rrethit të dytë u administruan në mënyrë efikase dhe ishin me konkurrencë të lartë. Megjithatë, vazhdimi i mbulimit partiak mediatik dhe mosndarja e qartë e aktiviteteve shtetërore dhe atyre partiake e vërtetoi mungesën e mundësive të barabarta për garimin e kandidatëve. Nevojiten përpjekje plotësuese për t'i trajtuar zbrazëtitrat dhe paqartësitë në Kodin Zgjedhor dhe për ta rritur besimin në listën zgjedhore të votuesve. Në përgjithësi, dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe në rregull.

Ndërmjet dy rrethëve zgjedhore, Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KShZ) vazhdoi me mbledhjet e rregullta, duke iu përmbajtur afateve të caktuara zgjedhore. Ndërkohë që KShZ-ja i realizoi aktivitetet e saja në mënyrë transparente dhe kryesisht efikase, kolegialiteti u përkeqësua dukshëm gjatë shqyrtimit të ankesave, me vendimet kryesisht të bazuara në përkatësinë partiake dhe jo në arsyeshmërinë ligjore.

¹ Shih Deklaratën për konstatimet dhe përfundimet preliminare për rrethin e parë të zgjedhjeve të lokale, të mbajtura më 24 mars 2013, që gjendet në: <http://www.osce.org/odihr/elections/100311>.

Kornizës ligjore për rrethin e dytë të zgjedhjeve lokale i mungonin detaje për çështjet kyçe që kanë të bëjnë me regjistrimin e votuesve, fushatën zgjedhore, financimin e fushatës zgjedhore dhe mbulimin e mediave. Ndonëse autoritetet ndërmorrën disa hapa për ndreqjen e mangësive procedurale që u vërejtën gjatë rrethit të parë të zgjedhjeve, edhe më tej mbetet nevoja për reforma të vazhdueshme zgjedhore.

Nga shumë bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it, shqetësimi i vazhdueshëm për saktësinë e listave zgjedhore u shtua edhe më tepër në rrethin e parë të zgjedhjeve, pasi që një numër votuesish nuk ishin në listat zgjedhore ndonëse kishin dokumente valide biometrike për identifikim. KShZ-ja vendosi që në rrethin e dytë të mos e lejojë votimin e qytetarëve me pasaporta biometrike, adresa e të cilëve është në Republikën e Shqipërisë, ndonëse ata ishin të përfshirë në listat zgjedhore dhe janë lejuar të votojnë në rrethin e parë.

Ambienti i fushatës ishte konkurrues dhe kandidatët në përgjithësi kishin mundësi ta zhvillojnë fushatën e tyre në mënyrë të lirë. Fushata mbeti aktive dhe e qetë, ndonëse fitoi ton më negativ ku disa kandidatë u akuzuan për aktivitete joligjore nga kundërshtarët e tyre në rrethin e parë të zgjedhjeve. Vazhduan akuzat për frikësimin e votuesve dhe keqpërdorimin e resurseve shtetërore. Kjo shkaktoi brengosje për mundësinë që votuesit të votojnë “pa u frikësuar nga hakmarrja”, si që parashihet në paragrafin 7.7 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990. Mosndarja e qartë e aktiviteteve shtetërore dhe atyre partiake është në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.

Mediat publike dhe private që u mbikëqyrën nga MVZ i OSBE/ODIHR-it vazhduan të shfaqin anshmëri në favor të partive në pushtet. Transmetuesi publik vendosi të mos u ndajë kohë të lirë kandidatëve dhe të mos mbajë debate, duke e kufizuar spektrin e informatave, që votuesit të bëjnë zgjedhje të bazuar në informim. Gjatë raportimit të lajmeve, mediat elektronike kryesisht dështuan ta bëjnë dallimin ndërmjet aktiviteteve shtetërore dhe fushatës zgjedhore të partive.

KShZ-ja dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk sollën vendim për mbi 500 parashtresave për fushatë të parakohshme zgjedhore dhe keqpërdorim të resurseve shtetërore, të cilat u dorëzuan përpara rrethit të parë, duke ju pamundësuar ankuesve mjetin ligjor për ndreqjen e hershme dhe efikase, si që parashihet në paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990. Parashtresat dhe ankesat për rrethin e parë të zgjedhjeve kryesisht u refuzuan për arsye procedurale, edhe pse u vendos që të ketë rivotim në katër vendvotime.

Si edhe në rrethin e parë, votimi në shumicën e vendvotimeve të vizituara nga MVZ i OSBE-ODIHR-it në përgjithësi u zhvillua në një mënyrë të qetë dhe në rregull, dhe procedurat në shumicë u ndoqën. Ekzistonin raste të votimit grupor dhe partitë vazhduan t'i shprehin brengat e tyre për diasporën e cila ktheheshte të votojë në ditën e zgjedhjeve.

KONSTATIMET PRELIMINARE

Konteksti

Më 24 mars u mbajtën zgjedhje për kryetarë të komunave dhe këshilla komunalë në të gjitha 80 komunat, si dhe në Qytetin e Shkupit. Kryetarët e komunave u zgjedhën sipas modelit të shumicës në dy rrethe zgjedhore, ndërsa këshilltarët u zgjedhën sipas modelit proporcional me një rreth zgjedhor. Katërdhjetë e nëntë kryetarë komunash u zgjedhën në rrethin e parë, duke e fituar shumicën e nevojshme të votave, ndërsa rrethi i dytë i zgjedhjeve ndërmjet dy kandidatëve me numër më të madh të votave u caktua të mbahet më 7 prill, për 29 komuna dhe Qytetin e Shkupit.²

Nga 49 kryetarët e komunave që u zgjedhën në rrethin e parë, 38 janë përfaqësues të Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), 7 janë përfaqësues të Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI) dhe nga 1 përfaqësues kanë Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM), Lidhja e Romëve të Maqedonisë (LRM) dhe Partia Demokratike e Turqve të Maqedonisë (PDTM); 1 kandidat ishte i pavarur. Dy femra u zgjedhën kryetare komune në rrethin e parë dhe dy tjera garuan në rrethin e dytë. KShZ-ja njoftoi se në rrethin e parë të zgjedhjeve në votime dolën 67% nga votuesit.

Dispozitat e Kodit Zgjedhor që kanë të bëjnë me rrethin e dytë nuk i trajtojnë disa çështje të rëndësishme. Këtu bën pjesë fillimi i fushatës zgjedhore, regjistrimi i votuesve që mbushin 18 vjet ndërmjet dy rretheve zgjedhore, dispozitat që kanë të bëjnë me financimin e fushatës zgjedhore, mbulimi mediatik dhe votimi i votuesve në shtëpi.

Administrimi i zgjedhjeve

KShZ-ja i shpalli rezultatet e plota preliminare për rrethin e parë të zgjedhjeve më 26 mars, duke i ndarë ato sipas komunave dhe vendvotimeve. Në një proces transparent, rezultatet u publikuan në ueb-faqen e KShZ-së pasi u morën nga KKZ-të, edhe pse 41 KKZ nuk e respektuan afatin e përcaktuar në Kodin Zgjedhor për dorëzimin e rezultateve.³ Më 2 prill, pasi përfundoi procesi i ankesave, KShZ-ja i shpalli rezultatet përfundimtare brenda afatit të paraparë ligjor.

Ndërmjet dy rretheve zgjedhore, KShZ-ja vazhdoi me mbledhjet e rregullta, duke iu përmbajtur afateve të caktuara zgjedhore. Ndërkohë që KShZ-ja i realizoi aktivitetet e saja në mënyrë transparente dhe kryesisht efikase, kolegialiteti u përkeqësua dukshëm gjatë shqyrtimit të ankesave, me vendimet kryesisht të bazuara në përkatësinë partiake dhe jo në arsyeshmërinë ligjore.

Në përputhje me ligjin, përbërja e komisioneve komunale zgjedhore (KKZ) dhe e këshillave zgjedhorë (KZ) mbeti e njëjtë edhe për rrethin e dytë të zgjedhjeve. Mirëpo, u zëvendësua KKZ-ja dhe 13 KZ në Çair, pas shkarkimit të tyre nga KShZ për shkak të falsifikimit të pretenduar të rezultateve të rrethit të parë zgjedhor. Ky rast është duke u hetuar nga Prokuroria Publike.

² Në dy komuna, në Dollnen dhe në Strumicë, më 7 prill u bë rivotimi për rrethin e parë të zgjedhjeve në disa vendvotime. Në Dollnen, rrethi i dytë i zgjedhjeve do të mbahet më 21 prill.

³ Sipas Kodit Zgjedhor, KKZ-të kanë afat prej 7 orëve nga mbyllja e vendvotimeve që t'i shpallin rezultatet preliminare në komunën e tyre, ndërsa Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit ka 10 orë.

U realizuan trajnime plotësuese për KZ-të nga disa KKZ, ku u trajtuan disa parregullësi procedurale që u vërejtën nga MVZ i OSBE/ODIHR-it në ditën e votimit të rrethit të parë të zgjedhjeve, duke e përfshirë edhe kompletimin e procesverbaleve të rezultateve. KShZ-ja siguroi informata për votuesit përmes spoteve televizive dhe posterëve, edhe në gjuhët e pakicave.

Regjistrimi i votuesve

Nga shumë bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it, shqetësimi i vazhdueshëm për saktësinë e listave zgjedhore u shtua edhe më tepër në rrethin e parë të zgjedhjeve, pasi që një numër votuesish nuk ishin në listat zgjedhore ndonëse kishin dokumente valide biometrike për identifikim. KShZ-ja nuk sollti vendim për 39 ankesa nga qytetarët që pohonin se nuk gjenden në listat zgjedhore. Më 2 prill, gjatë një mbledhjeje të gjatë dhe me kundërshtime, KShZ-ja vendosi që në rrethin e dytë të mos e lejojë votimin e qytetarëve me pasaporta biometrike, adresa e të cilëve është në Republikën e Shqipërisë, ndonëse ata ishin të përfshirë në listat zgjedhore dhe janë lejuar të votojnë në rrethin e parë.

Fushata dhe financimi i fushatës

Fushata zgjedhore zyrtarisht përfundoi më 5 prill në mesnatë, në pajtim me ligjin. Në komuna u shfaqën disa materiale të reja gjatë javës para rrethit të dytë të zgjedhjeve, përkrah posterëve, afisheve dhe billbordeve që kishin mbetur nga rrethi i parë. Edhe pse shumica e kandidatëve preferuan që votuesve t'u drejtohen nëpërmjet fushatës derë-më-derë dhe konferencave të rregullta për shtyp, shumë të tjerë mbajtën edhe takime me votuesit. Në garat mes dy kandidatëve të të njejtës përkatësi etnike, kandidatët shpesh kërkonin përkrahjen e votuesve jashtë grupit të tyre etnik. Në përgjithësi, fushata e partisë në pushtet, VMRO-DPMNE, ishte shumë më e dukshme.

Si edhe në rrethin e parë, fushata ishte konkurruese dhe kandidatët në përgjithësi kishin mundësi ta zhvillojnë fushatën e tyre në mënyrë të lirë, edhe pse vazhduan rastet e shfytirimit të posterëve zgjedhorë. Ndonëse atmosfera mbeti e qetë, toni i fushatës u bë më negativ dhe në disa komuna u paraqitën materiale propaganduese anonime me qëndrime kritike ndaj kandidatëve të caktuar. Disa kandidatë u akuzuan për aktivitete joligjore nga kundërshtarët e tyre në rrethin e parë të zgjedhjeve. Vazhduan akuzat për frikësimin e votuesve, kryesisht për nëpunësit publikë, duke e shkaktuar brengosjen për mundësinë e votuesve të votojnë "pa u frikësuar nga hakmarrja", si që parashihet në paragrafin 7.7 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.

Kryeministri dhe ministrat tjerë të qeverisë zhvilluan fushatë të fuqishme në emër të kandidatëve të partive të tyre, shpesh gjatë orarit të punës. Disa ministra promovuan projekte në komuna ku u mbajt rrethi i dytë i zgjedhjeve dhe premtuan përkrahje të vazhdueshme nga pushteti qendror në qoftë se zgjidhet kandidati i partisë në pushtet. Më 30 mars, qeveria njoftoi për një plan të madh për rindërtimin dhe ndërtimin e shkollave të reja anembanë vendit, duke i përfshirë edhe disa komuna ku kandidatët e partisë në pushtet garojnë në rrethin e dytë të zgjedhjeve. Akuzat për keqpërdorim të resurseve shtetërore vazhduan gjatë tërë rrethit të dytë, përfshirë edhe vendosjen e materialeve zgjedhore në pronë shtetërore nga kandidatët e partisë në pushtet. Mosndarja e qartë ndërmjet aktiviteteve partiake dhe atyre shtetërore shkaktonte shqetësime për mospasjen e mundësive të barabarta për garim ndërmjet kandidatëve,

që është në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.⁴

Të gjithë kandidatët që marrin pjesë në zgjedhje duhet të raportojnë për financimin e fushatës zgjedhore. Sipas informatave nga ueb-faqja e KShZ-së, 61 nga 121 kandidatë nuk e kanë dorëzuar raportin e dytë parazgjedhor financiar, që duhet ta bëjnë deri më 23 mars. Nuk është paraparë ndëshkim për mosdorëzimin e raporteve parazgjedhore. Sipas raporteve të dorëzuara deri tani, VMRO-DPMNE-ja ka pasur një avantazh të konsiderueshëm financiar anembanë vendit, duke shpenzuar pesë herë më tepër se konkurruesi i saj më i afërt. Raportet përfundimtare financiare të fushatës duhet të dorëzohen 30 ditë pas përfundimit të fushatës, por ligji nuk është i qartë nëse bëhet fjalë për rrethin e parë apo të dytë. As Kodi Zgjedhor nuk e parasheh në mënyrë të qartë nëse shuma e përgjithshme e lejuar për shpenzime të fushatës është për të dy rrethet zgjedhore. Për më tepër, meqë raportet financiare të fushatës nuk kanë ndarje të shpenzimeve sipas komunave, nuk ka mundësi të përcaktohet nëse është respektuar kufizimi i caktuar për shpenzimet.

Mediat

Përderisa rregullativat e Këshillit për Rradiodifuzion (KRD) parashohin që mediat ta mbulojnë në mënyrë të balancuar fushatën, korniza ligjore shumë pak e ka të rregulluar mbulimin mediatik të rrethit të dytë të zgjedhjeve⁵. Transmetuesi publik, Radio Televizioni i Maqedonisë (RTM) vendosi të mos ju ndajë kohë pa pagesë kandidatëve dhe të mos mbajë debate, duke e kufizuar spektrin e informatave, që votuesit të bëjnë zgjedhje të bazuar në informim.

Si edhe në rrethin e parë të zgjedhjeve, mbikëqyrja e mediave nga ana e MVZ të OSBE/ODIHR-it tregoi një anshmëri të dukshme ndaj partive në pushtet - në aspekt të sasisë dhe tonit të raportimit⁶. Të gjitha mediat e mbikëqyrura elektronike, përveç televizionit *Telma*, i mbuluan gjerësisht aktivitetet qeveritare në komunat ku u mbajt rrethi i dytë të zgjedhjeve, pa e bërë dallimin ndërmjet aktiviteteve shtetërore dhe fushatës së partive.

Përkundër obligimeve ligjore, Transmetuesi Publik RTM nuk ofroi mbulim të balancuar të fushatës. *RTM-1*, 21% të lajmeve ia kushtoi qeverisë dhe 37% VMRO-DPMNE-së, kryesisht me ton pozitiv ose neutral, ndërsa *LSDM*-ja kishte mbulim kryesisht negativ ose neutral prej 29%. *RTM-2*, që ofron program në gjuhën e pakicave, ofroi mbulim kryesisht neutral, me atë që 33% të mbulimit ia kushtoi BDI-së dhe 17% PDSH-së.

Kanalet private, *Sitel* dhe në një masë më të vogël *Kanal 5*, ofruan lajme të favorshme për qeverinë dhe VMRO-DPMNE-në dhe ishin shumë kritikuese ndaj *LSDM*-së, ndërsa *Telma* dhe *Alsat-M*, ofruan mbulim më neutral. *Sitel*, 42% të kohës së lajmeve ia kushtoi VMRO-DPMNE-së, 32% *LSDM*-së dhe 15% qeverisë. *Kanal 5*, 34% ia

⁴ Paragrafi 5.4 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 parasheh “ndarje të qartë ndërmjet shtetit dhe partive politike. Në veçanti, partitë politike nuk do të bashkohen me shtetin”.

⁵ Për shembull, nuk definohet fillimi i fushatës për rrethin e dytë të zgjedhjeve. Ndërkohë që mediat kryesore elektronike filluan të emitojnë reklama politike që nga 26 marsi, KRD-ja filloi me monitorimin e mediave vetëm prej 27 marsit.

⁶ Për rrethin e dytë të zgjedhjeve, *MMZ*-ja e OSBE/ODIHR-it e mbikëqyri mbulimin e lajmeve në periudhën më të shikuar (prej orës 18:00 deri në orën 24:00) në gjashtë kanale televizive: *RTM-1*, *RTM-2*, *Alsat-M*, *Kanal5*, *Sitel* and *Telma*.

kushtoi VMRO-DPMNE-së, 23% LSDM-së dhe 21% qeverisë. *TV Telma*, 28% ia kushtoi VMRO-DPMNE-së, 35% LSDM-së. *Alsat-M* më tepër u përqëndrua te partitë politike të shqiptarëve dhe 27% të kohës ia kushtoi BDI-së, 15% PDSH-së dhe po aq LSDM-së, dhe 14% VMRO-DPMNE-së.

Mbikëqyrja e mediave nga KRD-ja identifikoi mungesë të balancit gjatë emitimit të lajmeve të shumica e mediave elektronike në favor të partive në pushtet; mirëpo KRD-ja vendosi të reagojë për këto shkelje vetëm pas rrethit të dytë zgjedhor.

Parashtresat dhe ankesat

KShZ-ja nuk solli vendim për 431 ankesat që u dorëzuan para ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë, lidhur me akuzat për fillim të parakohshëm të fushatës. Poashtu, 73 ankesa të cilat LSDM-ja ia dorëzoi Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KShPK), duke pretenduar për keqpërdorim të resurseve shtetërore gjatë fushatës zgjedhore të VMRO-DPMNE-së, akoma janë në pritje të përgjigjes. Mungesa e procedurave të qarta për trajtimin e ankesave parazgjedhore nuk garanton ndreqje efektive, si që parashihet në paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopenhagës të vitit 1990⁷.

Pas votimit në rrethin e parë të zgjedhjeve, 8 parti politike dhe koalicione dorëzuan 402 ankesa në KShZ, me të cilat kundërshtojnë rezultati në 476 vendvotime, 6 prej të cilave u pranuan.⁸ U sollën vendime kundërthënëse për ankesa që pretendonin parregullsi të njëjta. Shumica e ankesave u refuzuan për arsye procedurale, për shkak se nuk ishin dorëzuar dëshmi ose për shkak se ankesa nuk ishte shënuar në proceverbalin e votimit të KZ-së ose të KKZ-së. Të tjerat u refuzuan për shkak se dy ankesa nuk ishin dorëzuar në vendvotimin e njëjtë, si që parashihet me Kodin Zgjedhor. OSBE/ODIHR ka rekomanduar edhe më parë që kjo dispozitë të hiqet, për shkak se e eliminon mundësinë për të siguruar ndreqje efikase ligjore.

Duke u bazuar në ankesat e miratuara, KShZ-ja i anuloi rezultatet në tre vendvotime në Strumicë për shkak të parregullsive të bazuara në ankesat e VMRO-DPMNE-së, si dhe në një vendvotim në Dollnen në bazë të ankesës së PDSH-së. Në komunën e Çairit, KShZ-ja votoi për t'i kontrolluar materialet zgjedhore në 13 vendvotime në bazë të ankesës nga PDSH-ja, e cila pretendonte se rezultatet në procesverbalin e KKZ-së nuk përputheshin me ato të KZ-ve. KShZ-ja e miratoi ankesën dhe i ndryshoi rezultatet në 13 vendvotime, duke rezultuar me rrethin e dytë zgjedhor në Çair.

Gjykata Administrative pranoi 142 ankesa, prej të cilave 141 u refuzuan si të pabaza. U pranua një ankesë e VMRO-DPMNE-së për një vendvotim në Kërçovë, por votimi i rrethit të parë nuk u përsërit për shkak se kjo nuk do ta ndryshonte rezultatin përfundimtar. Seancat dëgjimore publike të cilat i vëzhgoi MVZ i OSBE/ODIHR-it ishin formale, në të cilat parashtruesit e ankesave nuk prezantuan asnjë dëshmi.

⁷ Paragrafi 5.10 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 parasheh që “çdokush do të ketë mjete efektive për ndreqje ndaj vendimeve administrative, për ta garantuar respektimin e të drejtave fundamentale dhe për ta siguruar integritetin ligjor”.

⁸ LSDM-ja dorëzoi 371 ankesa; Ripërtirja Demokratike e Maqedonisë dorëzoi 35 ankesa, VMRO-DPMNE-ja dorëzoi 5 ankesa, PDSH-ja dorëzoi 3 ankesa, PDTM-ja dorëzoi 2 ankesa, BDI-ja dorëzoi 1 ankesë, Lëvizja popullore për Maqedoninë dorëzoi 1 ankesë, Rilindja Demokratike Kombëtare dorëzoi 1 ankesë.

Më 3 prill, KShPK-ja e paralajmëroi ngritjen e procedurës kundërvajtëse sipas detyrës zyrtare kundër Andrej Zhernovskit, kandidatit të opozitës në komunën Qendër, me pretendimin se ka pasur parregulsi në raportet financiare deri sa ka qenë deputet në Kuvend, në periudhën 2002 dhe 2011. Z. Zhernovski tha se koha e publikimit është e motivuar politikisht.

Dita e zgjedhjeve

Si edhe në rrethin e parë, votimi në shumicën e vendvotimeve të vizituara nga MVZ i OSBE-ODIHR-së në përgjithësi u zhvillua në një mënyrë të qetë dhe në rregull, dhe procedurat në përgjithësi u ndoqën. Procesi i votimit ishte i qetë dhe anëtarët e KZ në vendvotimet e vizituara i ndiqnin procedurat dhe e menaxhonin procesin në mënyrë efikase. U vëzhgua një numër i rasteve të votimit grupor. Përderisa disa vendvotime e pezulluan procesin e votimit për një kohë të shkurtër për t'i shqyrtuar çështjet teknike ose ankesat, kjo nuk ndikoi negativisht mbi procesin e votimit. Si edhe në rrethin e parë, disa parti shprehën brengat e tyre për numrin e madh të qytetarëve nga diaspora të cilët ktheheshin për të votuar në ditën e zgjedhjeve.

Në vendvotimet e vizituara, numrimi i votave u bë në një mënyrë profesionale dhe transparente me vetëm disa gabime procedurale të vëzhguara. Procesi i grumbullimit të votave dukeshite se është mirë i administruar në ato disa KKZ të vizituara. KShZ filloi t'i shpallë rezultatet zgjedhore gjatë natës së zgjedhjeve dhe i publikoi në ueb-faqen e tij sipas komunave dhe vendvotimeve.

Votimi i hershëm u organizua më 6 prill për votuesit në shtëpi, të burgosurit dhe personat e zhvendosur brenda vendit. Si edhe në rrethin e parë, fshehtësia e votës për votuesit në shtëpi jo gjithmonë u respektua dhe u vërejtën edhe raste të të burgosurve të cilët nuk ishën në listën e votuesve.

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.
Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.*

INFORMATA PËR MISIONIN DHE MIRËNJOHJE

Shkup, 8 prill 2013 – Misioni për Vëzhgim të Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR-it u hap në Shkup më 25 shkurt me 11 ekspertë në kryeqytet dhe 16 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në mbarë vendin. Në ditën e zgjedhjeve të rrethit të parë u shpërndanë 215 vëzhgues afatshkurtër, duke përfshirë edhe delegacionin 15-anëtarësh nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës. MVZ i OSBE/ODIHR-it mbeti në vend me kapacitet të zvogëluar për ta mbikëqyrur rrethin e dytë të zgjedhjeve më 7 prill. Në përgjithësi, kishte vëzhgues nga 30 vende anëtare të OSBE-së.

MVZ- i OSBE/ODIHR-it dëshiron ta falënderojë Ministrinë e Punëve të Jashtme për ftesën për t'i vëzhguar zgjedhjet, Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve për bashkëpunimin dhe sigurimin e dokumenteve për akreditim, si dhe organet e tjera për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre. MVZ- i OSBE/ODIHR-it dëshiron t'i shprehë

falënderim edhe Misionit të OSBE-së në Shkup dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe përkrahjen e tyre.

Për informata plotësuese, ju lutemi kontaktoni:

- Ambasadorin Geert-Hinrich Ahrens, Shef i MVZ i OSBE/ODIHR-it në Shkup, (+389 (0)2 3255 200);
- Z. Thomas Rymer, Zëdhënës i OSBE/ODIHR-it, (+48 609 522 266) ose zonjën Tamara Otiashvili, Këshilltare për Zgjedhje në OSBE/ODIHR në Varshavë (+48 22 5200 680);

Adresa e MVZ të OSBE/ODIHR-it

Bul. Ilinden, nr.76, 1000 Shkup

Tel: +389 (0)2 3255 200, Faksi: +389 (0)2 3255 201, E-mail: office@odihr.org.mk